



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.108/14 prot

Datë 05.03.2026

V E N D I M
Nr. 356/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 265/2026, datë 17.02.2026 për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “*Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT*”, me fond limit 9.462.524 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Kreatx” SHPK, me NUIS L12121023B me adresë: Rruga “Robert Shvarc”, godina “Niku Constraksiun”, kati nr.1 teknik, hyrja nr.2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A, me adresë: Rajoni Nr.1, Rruga: “Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë

13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 17.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 265/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”, me fond limit 9.462.524 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.14/17 prot., datë 23.02.2026, protokolluar me tonën nr. 108/9 prot., datë 26.02.2026, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë SH.A informon KPP-në se: “Në zbatim të [...] vendimit të KPP nr.265/2026 , datë 17.02.2026 procedura e prokurimit me objekt: “Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”, me fond limit 9.462.524 lekë pa TVSH është kthyer në fazën e rivlerësimit në SPE dhe KVO është në zbatim të detyrimit procedural të kërimit të sqaruimeve nga OE «Keatx» SHPK. Pasi të vijë përgjigja nga «Kreatx» SHPK, KVO do të vazhdojë me rivlerësimin dhe në vijim AK do të vazhdojë të vërë në dijeni KPP”.

I.3. Me shkresën nr.14/20 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 108/10 prot., datë 02.03.2026, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 265/2026, datë 17.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit , bashkëngjitur vendimi i KVO-së datë 26.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.14/17 prot., datë 23.02.2026, protokolluar me tonën nr. 108/9 prot., datë 26.02.2026, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A informon KPP-në se: *“Në zbatim të [...] vendimit të KPP nr.265/2026 , datë 17.02.2026 procedura e prokurimit me objekt: “Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”, me fond limit 9.462.524 lekë pa TVSH është kthyer në fazën e rivlerësimit në SPE dhe KVO është në zbatim të detyrimit procedural të kërimit të sqarimeve nga OE «Keatx» SHPK. Pasi të vijë përgjigja nga «Kreatx» SHPK, KVO do të vazhdojë me rivlerësimin dhe në vijim AK do të vazhdojë të vërë në dijeni KPP”.*

II.2. Me shkresën nr.14/20 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 108/10 prot., datë 02.03.2026, autoriteti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë SH.A informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 265/2026, datë 17.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit , bashkëngjitur vendimi i KVO-së datë 26.02.2026.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr. 265/2026, datë 17.02.2026. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr. 265/2026, datë 17.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e mësipërme të prokurimit, në përputhje me vendimin e KSHA-së dhe arsyetimet e konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65394-10-16-2025, me objekt: “*Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT*”, me fond limit 9.462.524 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

